




Dokumenti / Dokument Number / Number		24.02.2022	2	viti / god year
Çfaqja / Faqja Page / Page	Drejtimi / Drejtimi Dirig / Dir	Shtypja / Print Appendix	Sasia / Krahuna Quantity	
SKIMSHUK	986/2022		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.65/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.65/2022 të datës 26.01.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit/Komuna e Kllokotit, në çështjen juridike-administrative "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 24.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.65/2022 të datës 26.01.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datën 26.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me shpalljen e konkursit për pozitën "Korrir" në Shkollën Gjon Sereqi në fshatin Mogillë të Komunës së Kllokotit, me pretendimet ankimore që komisioni ka bërë shkelje ligjore dhe procedurale lidhur me atë se nuk janë përfillur kriteret e konkursit, nuk është publikuar konkursi, nuk janë publikuar rezultatet e konkurentëve, si dhe kërkon që ky konkurs të anulohet.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 26.01.2022 me nr.protokolli 360/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 02.12.2021 e parashtruar në Komisionin për Rekrutimin e Personelit Teknik pranë Drejtorisë për Arsim, Kulture, Rini, Sport dhe Çështje Sociale; Kërkesën e ankuesit të datës lidhur me qasjen në

dokumente zyrtare; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.02.2022 e parashtruar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 11.02.2022 nga Komuna e Kllokotit me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin e shpallur në gazetën Bota Sot; Vendimin me numër Nr.239/1 të datës 18.10.2021 për formimin e Komisionit intervistues; Listën me aplikacionet e pranuar të kandidatëve të datës 26.10.2021; Lajmërimin e datës 25.10.2021 për kandidatët të cilët kanë marrë pjesë në testimin me shkrim; Procesverbalin e datës 29.10.2021 për rezultatet e testimit me shkrim; Njoftimin me numër Nr.prot.294/1 të datës 30.10.2021 lidhur me rezultatet e arritura nga testi me shkrim dhe njoftimin për kandidatet për intervistën me gojë; Procesverbalin e Komisionit me numër Nr.protokolli 293/1 të datës 01.11.2021 për listën përfundimtare; Listën përfundimtare e kandidatit të përzgjedhur(rekomandimin) me numër protokolli 319/1 të datës 17.11.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton së Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, është konstatuar se ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 01.10.2021, të shpallur nga Komuna e Kllokotit për pozitën "Korrier" në Shkollën Gjon Sereqi në fshatin Mogillë. I njëjti me datën 26.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore që komisioni ka bërë shkelje ligjore dhe procedurale lidhur me atë se nuk janë përfillur kriteret e konkursit, nuk është publikuar konkursi, nuk janë publikuar rezultatet e konkurentëve, si dhe i njëjti kërkon që ky konkurs të anulohet.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës*" dhe se të punësuarit që kryejnë veprimtari ndihmëse dhe të mirëmbajtjes janë kategorizuar si nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës ashtu siç përcaktohet edhe me nenin 2 paragrafin 6 ku theksohet se: 6. *"Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike"*, ka konstatuar se pozita "Korrier" për të cilën ka aplikuar ankuesi hyn në kategorinë e nëpunësve të shërbimit administrativ dhe mbështetës, rrjedhimisht pozita në fjalë nuk është pozitë në shërbim civil. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.65/2022 të datës 26.01.2022, të parashtruar nga

Në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon ankuesin se nëpunësi administrativ dhe mbështetës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.


Kështu që, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.65/2022

Ardita Perçuku-SHYTI


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Klllokotit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Klllokotit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

